



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: “ **Arhiko Ing O.P.**” me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 11.06.2020, merr këtë:

### **V E N D I M**

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: “ **Arhiko Ing O.P.** ” me seli në Prishtinë, në procedurën e prokurimit me titull: “ **Hartimi i projekteve “ Nr.i prokurimit: VU644 – 20 – 713 – 2-1-1 e Nr. i brendshëm: 644-20-008-211.**”
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 01.06.2020

### **A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ( në tekstin e mëtejme A.K. ) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës O.E.: **N.T.SH. “ Infratek ” me seli në Lipjan** ndërsa, O.E.: “ **Arhiko Ing O.P.**” me seli në Prishtinë ( në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta eliminoi si O.E. të papërgjegjshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **02.06.2020**, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. 01.06.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 7– Barazia dhe Trajtimi, nenin 13 – Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, nenin 69 – Aftësia teknike dhe / ose profesionale, nenin 72 – dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës neni 10 – kontrata e punës.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

- Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 ( Procedurë e Hapur ) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 ( **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** ) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimi dhe vlerësimi të tenderëve të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 01.06.2020 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.
- Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë

procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik: N.T.SH. " Infratek " me seli në Lipjan " është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

3. Më tej, A.K., bazuar në procesin e vlerësimit dhe ekzaminimit të Listës së shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë si dhe referencave të dorëzuara për të dëshmuar vlerën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit, ka konstatuar se vlera e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit e dëshmuar përmes referencave nuk përmbushë vlerën e kërkuar prej 400.000,00€ ashtu sikurse është saktësuar në Fleta e të Dhënave të Tenderit, Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, neni 9.1 lidhur 9.2 pika 1. Duke qenë se A.K. ka vlerësuar se dokumentacioni i dorëzuar në dukje është jo i plotë, në pajtim me dispozitat e nenit 72 pika 1 të LLP-së lidhur me nenin 41.7 të RRUOPP, më dt. datë 30.04.2020 përmes Kërkesës – Dokumentit standard për sqarim tenderi dërguar përmes Platformës elektronike – e-prokurim dhe e-mail ka kërkuar informatë plotësuese lidhur me disa dëshmi shtesë për të qartësuar plotësimin ose jo të kërkesave lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale të tenderuesit, në këtë rast Ankuesit. Ankuesi, brenda afatit të saktësuar në kërkesë, nuk i ka dorëzuar, as në e-mail dhe as , në pajtim me nenin 39.8 të RRUOPP, citat:" A.K. duhet ti dërgojë Kërkesë për sqarim tenderi O.E. përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe O.E. duhet ta dorëzojë përgjigjen e tyre tek A.K. në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik" mbarim citati, nuk i ka ngritur në platformën e e-prokurimit, dëshmitë e kërkuara që tregojnë apo pohojnë se ai i përmbushë Kërkesat mbi aftësitë teknike dhe / ose profesionale, sikurse parashihet në nenin 69 të LPP-së, lidhur me nenin 9.1 & 9.2 pika 1 të Fleta e të Dhënave të Tenderit ( FTD ) të Dosjes së Tenderit dhe nenin 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. Si Autoritet Kontraktues, nuk kemi marrë asnjë përgjigje dhe / ose shpjegim nga Ankuesi lidhur me kërkesën e parashtruar brenda afatit kohorë të dhënë dhe po ashtu nuk kemi marrë asnjë informatë mbi ndonjë arsye të mosdorëzimit me shkrim të dëshmimeve të kërkuara. Rrjedhimisht, për shkak se vlera e shërbimeve të përfunduara suksesshëm në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, të dëshmuara përmes referencave kapë shumën prej 330.797,65€ që donë të thotë se nuk përmbushë vlerën prej 400.000,00€ ashtu sikurse është kërkuar në pikën 1 të nenit 9.1 lidhur me 9.2 të FTD-së si dhe për shkak të mos përgjigjes së Ankuesit në kërkesën e A.K. për dëshmi shtesë, A.K. , në pajtim me nenin 39 pika 39.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik. citat : " dështimi i O.E. për ti paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit të saktësuar në kërkesë, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdoi me procedurën, në pajtim me dispozitat e LPP-së që rregullojnë këtë situatë " mbarim i citatit, ka vendosur që tenderi i Ankuesit të refuzohet për arsyet sikurse u theksua më lartë në këtë njoftim.
4. Mbi këto konstatime të A.K., dhe mbi bazën e pretendimit të Ankuesit se Ankuesi i ka dërguar A.K. dëshmitë e kërkuara në e-mailin zyrtar : [prokurimi.vushtrri@rks-gov.net](mailto:prokurimi.vushtrri@rks-gov.net) , A.K. në rrugë zyrtare , me Kërkesë, i është drejtuar Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit më tej ( ASHI ) në mënyrë që ky i fundit të vërtetoi pretendimet e Ankuesit se, më dt. 04.05.2020, a ka pasur komunikim zyrtar mes e-mailit të Ankuesit dhe e-mailit të A.K. Në përgjigjen e tij me shkrim ASHI informon zyrtarisht A.K. se citat: " bazuar në kriteret e përcaktuara për kërkim elektronik, nga zyra e prokurimit në KK-Vushtrri, për datën 04.05.2020 mes adresës elektronike : [arhiko.ing@gmail.com](mailto:arhiko.ing@gmail.com) dhe llogarisë elektronike zyrtare: [prokurimi.vushtrri@rks-gov.net](mailto:prokurimi.vushtrri@rks-gov.net), në skanerin e domenit: @rks-gov.net nuk është gjetur ky komunikim" mbarim citati. Bazuar në konstatimin e ASHI-së, A.K. vërteton padiskutueshëm se Vendimi i A.K. për eliminim të Ankuesit nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit është marrë në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 39 pika 30.7 të RROUOP.
5. Sa i përket pretendimit të Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Deklaratën në Betim të nënshkruar nga personi i paautorizuar, A.K. konstaton se një pretendim

i tillë i Ankuesit është i pabazuar për faktin se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës, bashkëpunim me dokumentacionin tenderues, ka dorëzuar edhe Autorizimin të nënshkruar dhe vulosur, me përmbajtje të qartë, andaj si i tillë ky pretendim është hedhur poshtë si i pasaktë, ndërsa që A.K. në mënyrë të drejtë ka vlerësuar dhe vendosur kur ka marrë për bazë validitetin e dokumenteve të dorëzuara dhe / ose nënshkruara nga personi i autorizuar.

6. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se kontratat e punës dhe / ose marrëveshjet e bashkëpunimit të stafit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk janë hartuar sipas ligjit të punës, A.K. konstaton se, si në Dosjen e Tenderit dhe / ose Njoftimin për kontratë, nuk është kërkuar nga asnjë O.E. që të marrin përsipër që të dorëzojnë një dokument në ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin. Pavarësisht nga kjo A.K. ka mundur në çdo moment kur e ka konsideruar të domosdoshme apo kur e ka konsideruar një dokument jo të plotë ose të paqartë të kërkojë informatë sqaruese nga secili O.E. pra edhe ndaj O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës, por që në këtë situatë nuk e ka konsideruar të nevojshme për faktin se përmbajtja e dokumentit – kontrata, sikurse ka vlerësuar A.K., është shumë e qartë duke i përmbajtur në vete gjitha elementet thelbësore dhe të domosdoshme. Për A.K. ka qenë më e rëndësishme përmbajtja dhe qartësia e dokumentit sesa edhe forma e tij. Andaj, konstaton A.K. se edhe ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë është hedhur poshtë.
7. Gjithashtu edhe sa i përket pretendimit të Ankuesit se A.K. ka shkelur nenin 13 të LPP-së kur ka pranuar si të rregullt dëshminë – Diplomën e Ingjinerit të Gjeodezisë në gjuhën kroate, A.K. vlerëson se ky pretendim është i pasaktë dhe për rrjedhojë edhe pa bazë ligjore për faktin se gjuha kroate si edhe ajo serbe janë të barazvlefshme dhe barazkuptueshme për A.K., ndërsa që dokumenti në fjalë, pra diploma, nuk është dokument i paqartë, si i tillë është vërtetuar tek noteri dhe po ashtu është dokument që nuk përkthehet, ndërsa kurë është lëshuar dokumenti i tillë, në vitin e largët 1997, ka qenë krejt një realitet tjetër nga ky sot. Andaj, bazuar në këtë që u tha më sipër, A.K. ka vërtetuar se edhe pretendimi i Ankuesit se A.K. ka shkelur nenin 13 të LPP-së kur ka pranuar si të rregullt dëshminë – diplomën në gjuhën kroate është i pabazuar dhe për rrjedhojë është hedhur poshtë.
8. Në fund A.K. më tej vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: **N.T.SH. "Infratek"** nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, konkretisht neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kriteve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K., janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha më lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
K.R. nr. 008/2020 - datë 11/06/2020

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik

  
Hyda Dallku-ZPP